

Në bazë të nenit 13, alineja 1 e Ligjit të Qendrës shtetërore për provime (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 59/25) dhe neni 5 alineja 1 e Rregullores së mënyrës, procedurës dhe kritereve për zgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës shtetërore të provimeve, nr. 01-440/3 të datës 28.12.2022, nr. 01-176/3 të datës 1.3.2023, nr. 01-197/3 të datës 15.04.2024, nr. 01-109/3 të datës 11.02.2025 dhe nr. 01-157/4 të datës 25.03.2025, Qendra shtetërore për provime Shkup shpall:

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues

I. Qendra Shtetërore për provime Shkup shpall konkurs publik për zgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm- vlerësues të testeve të pjesës eksterne të maturës shtetërore për vitin shkollor 2024/2025, në lëndët:

- 1) Gjuhë dhe letërsi maqedonase;
- 2) Gjuhë dhe letërsi shqipe;
- 3) Gjuhë dhe letërsi turke;
- 4) Gjuhë dhe letërsi serbe;
- 5) Gjuhë angleze;
- 6) Gjuhë frënge;
- 7) Gjuhë gjermane;
- 8) Gjuhë ruse;
- 9) Gjuhë italiane;
- 10) Matematikë dhe
- 11) Estetikë / Filozofi.

II. Kandidatët duhet t’i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Të kenë të kryer së paku studime akademike të ciklit të parë nga fusha përkatëse;
- Të jenë nga radhët e mësimdhënësve të lëndëve përkatëse mësimore në shkollat fillore ose të mesme në RMV dhe
- Të kenë së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në mësimdhënie

III. Kandidatët detyrimisht i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Aplikimin e plotësuar (formularin e aplikimit e keni të paraqitur në ueb-faqen: www.dic.edu.mk);
- Certifikatë shtetësie;
- Kopje të certifikatës/diplomës për studime të kryera përkatëse akademike të ciklit të parë, e verifikuar në noter dhe

- Vërtetim për marrëdhënie pune dhe përvojë përkatëse pune së paku 3 (tre) vjet si mësimdhënës në lëndën përkatëse mësimore në shkollat fillore ose të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në origjinal ose kopje të verifikuar në noter.

IV. Për kandidatët që i plotësojnë kushtet e lartpërmendura, Qendra shtetërore e provimeve Shkup do të organizojë trajnim, pas së cilës do të kontrollohen shkathtësitë dhe saktësia e kandidatëve gjatë vlerësimit të përgjigjeve/ zgjidhjeve të nxënësve.

Kandidatët që nuk kanë marrë pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtejme.

Për vlerësim të testeve nga pjesa eksterne të maturës shtetërore Qendra zgjedh vlerësues nga radhët e mësimdhënësve të shkollave të mesme që realizojnë mësimdhënie sipas lëndës që vlerësohet. Me përjashtim, nëse për vlerësues nuk mund të sigurohet mësimdhënës nga shkollat e mesme, përcaktohet mësimdhënës nga shkolla fillore, me arsimim të lartë të kryer dhe që realizon mësimdhënien sipas lëndës që e vlerëson.

- V. Zgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues kryhet në mënyrë dhe procedurë të paraparë sipas Rregullores së mënyrës, procedurës dhe kriterëve për zgjedhje të bashkëpunëtorëve të jashtëm të Qendrës shtetërore të provimeve.
- VI. Kandidatët që do të përzgjidhen për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues do të jenë të angazhuar deri më 30.09.2025.
- VII. Afati i paraqitjes nga kandidatët e interesuar është deri më 17.04.2025.
- VIII. Zgjedhja e bashkëpunëtorëve të jashtëm do të përfundojë më së voni në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) ditësh pas përfundimit të afatit të paraqitjes.
- IX. Dokumentacioni i vonuar, i pa plotë dhe i pavlefshëm nuk do të jetë lëndë shqyrtimi.
- X. Aplikimi i plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet VETËM NËPËRMJET POSTËS me dërgesë të rekomanduar postare, ose me postë të shpejt në adresën në vijim: Qendra shtetërore për provim – Shkup, rr. Vasil Gjorgov” p.n. 1000 Shkup, me theks “**Për konkursin publik për bashkëpunëtorë të jashtëm – vlerësues për lëndën ...**” (theksohet lënda për të cilin vlerësim paraqitet kandidati)
- XI. Informacione shtesë për konkursin publik mund të merren në numrin e telefonit 075/258-862, çdo ditë pune nga ora 10.00 deri më ora 14.00.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE SHKUP